



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 102 prot.

Tiranë, më 14. 01. 2025

V E N D I M

Nr. 17, datë 14. 01. 2025

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar², mori në shqyrtim ankesën nr. 116, datë 29.05.2024, të paraqitur nga A. K., në emër³ të bashkëshortes së tij, Sh. K., kundër Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë KMD-së, ndër të tjera, A. K. parashtron se: “...jam person me aftësi të kufizuara. Së bashku me bashkëshorten, Sh. K., kemi patur një rulotë në plazhin e Velipojës. Ne kemi ushtruar aktivitetin tonë si shitës ambulant me leje dhe si taksapagues të rregullt çdo vit. Këtë vit, IKMT ndërmori një aksion të befasishëm në zonën e plazhit pa asnjë paralajmërim dhe dhunoi rulotën, duke e shembur dhe shkatërruar, pa më sjellë asnjë njoftim paraprak. Unë jam një person invalid dhe kjo është e vetmja mënyrë me të cilën siguroj të ardhura për familjen time. Unë ndihem i diskriminuar për shkak të aftësisë time të kufizuar, sepse si invalid duhet të mbështetem për faktin se po mbijetoj me mundësitë e mia dhe duke paguar çdo taksë në shtet lidhur me aktivitetin tim dhe jo të më dhunohet objekti dhe ta shkatërrojnë në atë mënyrë. Theksoj që objekti është prishur pa praninë time dhe kanë dëmtuar edhe mallin që ka qenë brenda.”.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

³ Përmes autorizimit datë 27.05.2024.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, si dhe lejimin e tij të ushtrojë aktivitetin tregtar.

II. Procedura e ndjekur nga Komisioneri për shqyrtimin e ankesës.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7 i LMD-së, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/b të Ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar në nenin 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Përmes shkresës nr. 829/2 prot., datë 03.06.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁴ informoi dhe kërkoi informacion nga ana e IKMT, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë nga ana e subjektit ankues.

Në përgjigje sa më sipërcituar, përmes shkresës⁵ nr. 4434/1, datë 26.04.2024, IKMT vuri në dispozicion informacionin e kërkuar, duke sqaruar ndër të tjera se: “...IKMT në njohje dhe zbatim të ligjit nr. 9780/2007 “Për inspektim dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” ushtron detyrat e saj funksionale në bazë të një plani pune të miratuar ku një pikë e këtij plani është aksioni për marrjen e masave për lirimin e hapësirës bregdetare nga ndërtimet pa leje apo abuzimet me lejet e ndërtimit.

⁴ Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

⁵ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 829/3 prot., datë 14.06.2024.

Në kuadër të këtij aksioni, DRIKMT Shkodër, ka marrë masat në evidentimin dhe inspektimin e objekteve të kundërligjshëm në vijën bregdetare të Qarkut Shkodër, nga ku në vijim të shkresës nr. 290/1 prot., datë 18.04.2024, është vijuar dhe me aktet administrative për paligjshmëritë e konstatuara deri në ekzekutimin e objekteve të kundërligjshëm.

Referuar rastit konkret, pas verifikimeve të kryera në Sektorin e Arkiv/ protokollit të IKMT, rezultojnë se janë mbajtur aktet administrative si më poshtë vijon:

- Proces verbal për konstatim kundërvajtje nr. 30, datë 18.04.2024 me nr. Serie 0003600 për kundërvajtjen “Kioskë me strukturë metalike mbuluar me panele sandviç dhe kolona me përmasa 4 x 2.5 m2 me kundërvajtës “ 1 Pidentifikuar” me adrese: Pulaj, plazh;
- Vendim për prishje të objektit të kundërligjshëm nr. 142, datë 18.04.2024 me nr. Serie 0001643;

Në zbatim të Urdhërit të Kryeinspektorit nr. 377, datë 19.04.2024, “Për prishjen e objekteve të Kundërligjshëm përgjatë vijës bregdetare, Qarku Shkodër” në datën 20.04.2024 është kryer ekzekutimi i Vendimit për prishje i sipërcituar.

Lidhur me pretendimet e subjektit për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar si dhe kërkesës për lejimin për ushtrimin e aktivitetit tregtar, bëjmë me dije se siç vërehet dhe nga dokumentacioni bashkëlidhur, është një aksion i ndërmarrë përgjatë vijës bregdetare me qëllim lirim të hapësirës bregdetare nga objektet informale gjithashtu informojmë se IKMT është një organ inspektues dhe nuk ka kompetenca për lejimin ose jo të subjekteve, në ushtrimin e aktiviteteve tregtare.”

Bashkëngjitur shkresës së sipërcituar IKMT vuri në dispozicion të Komisionerit:

- Shkresa “Njoftim Proces-Verbali për Konstatimin e Kundërvajtjes”, Nr. 290/1 prot., datë 18.04.2024;
- Urdhër Nr. 377, datë 19.04.2024 “Për prishjen objekteve të kundërligjshme përgjatë vijës bregdetare, Qarku Shkodër”;
- Procesverbal i mbajtur në datë 20.04.2024, për ekzekutimin e Vendimit për Prishje Objekti të përcaktuar në Urdhër Nr. 377, datë 19.04.2024;
- Vendim Nr. 142, datë 18.04.2024 “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”, me nr. serie 0004643;
- Foto të objektit të prishur të ankuesit;
- Procesverbal Nr. 30, datë 18.04.2024, me nr. serie 0003600 “Për konstatimin e kundërvajtjes”.

2. Në vijim, ankuesi pasi kishte marrë dijëni mbi dokumentacionin dhe parashtrimet e IKMT-së, përmes e-mail-it datë 20.06.2024, informoi Komisionerin, duke theksuar ndër të tjera se:

“...Në shkresën në fjalë thuhet se objekti nuk ka adresë, pra është i pidentifikuar. Kjo nuk është e vërtetë sepse objekti është i identifikuar dhe Bashkia zotëron hartat sipas lejeve përkatëse që marrin shitësit ambulantë dhe ne rezultojmë të regjistruar me NIPT, ku janë të shkruara qartë adresa dhe kontaktet tona. Ky pretendim i tyre nuk qëndron sepse ne jemi me leje nga vetë Bashkia dhe i kanë të dhënat tona. Thuhet që janë bërë njoftimet për prishjen e objekteve, ne jemi banorë

të qytetit të Shkodrës dhe tek kioska shkojmë vetëm gjatë sezonit të verës, kështu që njoftimi duhet të më bëhet tek adresa e pronarit në bazë të NIPT-it.

Objekti është i pajisur me matës për energjinë elektrike dhe IKMT ka kërkuar shkëputjen e energjisë elektrike para prishjes së objektit OSHEE-së. Matësi ka një numër kontrate dhe emër mbiemër dhe fare thjeshtë mund ta kishin identifikuar.

Duke qenë se objekti ka qenë i lëvizshëm nuk ka qenë nevoja ta shkatërrojnë, thjesht mund ta kishin bllokuar dhe transportuar në vend grumbullimi dhe jo ta shkatërrojnë në mënyrë mizore”.

3. Përmes shkresës Nr. 829/4 prot., datë 02.07.2024, Komisioneri i kërkoj IKMT-së, informacionin dhe dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Informacion dhe argumente lidhur me procedurën që ndjek IKMT për verifikimin e objekteve, si në rastin e subjektit ankues.
- A është njoftuar ankuesi lidhur me nisjen e procedurave të verifikimit apo prishjes së objektit të tij? Nëse po të vihet në dispozicion të Komisionerit një kopje e tyre.
- A ka IKMT të parashikuar një procedurë për verifikimin paraprak të objekteve që pretendohet se janë ndërtuar pa lejen përkatëse? Nëse po të vihet në dispozicion të KMD-së një kopje e saj.
- A merret informacion nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) apo institucioneve të vetëqeverisjes vendore, lidhur me pronësinë apo identifikimin e poseduesve/pronarëve të këtyre objekteve? A është kërkuar nga ana e IKMT-së informacion nga ana e këtyre institucioneve lidhur me pronësinë apo poseduesit e këtyre objekteve të cilat i janë nënshtruar procedurës së prishjes?
- A janë të parashikuara afate gjatë të cilave poseduesit e objekteve, si në rastin e ankuesit, të marrin masat e nevojshme për spostimin apo çmontimin e tyre? Nëse po, kopje e dokumentit ku janë të parashikuara.
- Cilat kanë qenë arsyet e prishjes së objekteve nga ana e IKMT-së në zonën e plazhit të Velipojës?

Sa më sipër nga ana e IKMT-së nuk u vu në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion shtesë.

4. Në këto kushte, për administrimin e plotë të informacionit të kërkuar, për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë për një proces të rregullt ligjor, Komisioneri vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve. Në këtë kuptim me anë të shkresës nr. 829/5 prot., datë 09.09.2024 “Njoftim për seancë dëgjimore”, Komisioneri njoftoi palët lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 20.09.2024, si dhe kërkoj nga IKMT të vërë në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar me shkresën e sipërcituar Nr. 829/4 prot., datë 02.07.2024, për të cilën nuk është kthyer përgjigje.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca u zhvillua në datë 20.09.2024, me praninë vetëm të subjektit ankues, A. K.. Ndërsa nga ana e IKMT-së nuk u paraqit asnjë përfaqësues.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në. Ndër të tjera, ankuesi theksoi se prej 12 vitesh ushtron aktivitetin në të njëjtin vend dhe asnjëherë nuk është shqetësuar nga ana e strukturave të IKMT-së. Sipas tij, ai çdo vit është pajisur nga ana e Bashkisë Shkodër me leje dhe ka ushtruar aktivitetin e tij privat duke paguar taksat dhe çdo detyrim tjetër ndaj Ujësjetës apo OSHEE-së. Në rastin konkret, ankuesi sqaroi se nga ana e IKMT-së, pavarësisht se kioska kishte një matës të energjisë elektrike, nuk ka marrë asnjë masë për tu informuar për pronësinë mbi të, por ka shkëputur sahatin dhe ka vijuar me procesin e prishjes së objektit. Gjithashtu, ankuesi theksoi se gjatë sezonit veror 2024, e ka rindërtuar objektin dhe ka vijuar të ushtrojë aktivitetin e tij privat.

5. Me shkresën⁶ Nr. 4434/4 prot., datë 23.09.2024, e cila iu përcoll për dijeni Komisionerit, IKMT i drejtohej Drejtorisë Rajonale të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Shkodër, duke i kërkuar riverifikimin e problematikës dhe marrjen e masave sipas parashikimeve ligjore.
6. Në vijim, përmes shkresës Nr. 829/8 prot., datë 01.10.2024, Komisioneri i është drejtuar sërish IKMT-së, duke kërkuar të vërë në dispozicion të Komisionerit informacionin e cituar në shkresën Nr. 829/4 prot., datë 02.07.2024, të tij.

Në përgjigje sa më sipërcituar, IKMT me shkresën⁷ Nr. 4437/7 prot., datë 14.10.2024, informoi Komisionerin ndër të tjera se: *“...sikurse ju kemi bërë me dije përmes shkresës nr. 4434/4 prot., datë 23.09.2024, pretendimet e A. K., janë përcjell pranë Drejtorisë së IKMT Shkodër, ku në vijim, përmes shkresës nr. 312/3 prot., datë 27.09.2024, parashtron: Në zbatim të Urdhrit nr. 69, datë 30.04.2023, të Kryeministrit për “Ngritjen e Taks-Forcës Ndërinstitucionale të Sezonit Turistik Veror 2024”, Urdhrit të Kryeinspektorit Nr. 373, datë 17.04.2024 “Për ngritjen e grupit të punës në lidhje me kontrollin e zonave të plazheve”, të ligjit nr. 9780/2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, DRIKMT Shkodër, ka marrë masat për evidentimin dhe inspektimin e objekteve të kundërligjshëm në zonën e plazhit Velipojë, Qarku Shkodër, veçanërisht për rastet e lokaleve apo beach bar-eve.*

Gjatë kontrollit nga grupi i punës janë evidentuar objekte/ndërtimet pa leje ndërtimi në zonën e plazhit Velipojë.

Pretendimet e ankuesit se “objekti është lehtësisht i identifikueshëm pasi Bashkia zotëron hartat sipas lejeve përkatëse që marrin shitësit ambulant të regjistruar me Nipt, si dhe objekti është i pajisur me matës të energjisë elektrike, i cili ka numër kontrate dhe emër e mbiemër”, nuk e vërtetojnë faktin se ndërtimi është kryer nga i njëjti subjekt që ushtron aktivitetin privat në këtë objekt, si dhe matësi i energjisë elektrike mund të jetë në emër të një subjekti tjetër.

⁶ Protokolluar pranë Komisionerit me Nr. 829/7 prot., datë 25.09.2024

⁷ Protokolluar pranë Komisionerit me Nr. 829/9 prot., datë 16.10.2024

Sa i përket Procesverbalit me nr. 30, datë 18.04.2024, me nr. Serie 0003600, me kundërvajtës "I paidentifikuar", nga ana e DRIKMT Shkodër, nuk ka qenë i mundur identifikimi i subjektit. Gjithashtu, subjekti nuk ka qenë prezent gjatë inspektimit.

Në njohje të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodit të Procedurave Administrative", sipas së cilit Njoftimi bëhet publik në rastet:

- a) kur palët janë të panjohura;*
- b) kur vendi për njoftimin nuk është i njohur dhe njoftimi nuk është i mundur, sipas nenit 151 të këtij Kodi;*
- c) kur çdo formë tjetër njoftimi është e papërshtatshme apo e pamundur;*
- d) në çdo rast tjetër të përcaktuar shprehimisht nga ligji.*

Pika 2

Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, njoftimi i PVK-së së sipërcituar, është kryer nëpërmjet shkresës nr. 290/2 prot., datë 19.04.2024 "Kërkesë për shpallje", drejtuar Bashkisë Shkodër, ku nëpërmjet shkresës hyrëse nr. 290/26 prot., datë 04.06.2024, në DRIKMT Shkodër është bërë prezent konfirmimi për shpalljen nga Bashkia Shkodër.

Gjithashtu dhe njoftimi i vendimit të IKMT-së, është kryer nëpërmjet shkresës nr. 290/21 prot., datë 24.04.2024, drejtuar Bashkisë Shkodër për shpallje, ku në vijim përmes shkresës nr. 290/28 prot., datë 06.06.2024, është bërë prezent konfirmimi i shpalljes nga Bashkia Shkodër."

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm të ankuesit nga ana e IKMT-së.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe informacionit të depozituar pranë KMD-së, rezulton se, bashkëshortja e A. K., Sh. K., të paktën që nga viti 2022, ushtronte aktivitetin privat në plazhin e Velipojës, në zonën e quajtur Pulaj, Rruga Nr. 2, Ndërtesa Nr. 7.

Gjithashtu, mbështetur në Ekstraktin e Regjistrisë Tregtar të marrë nga faqja zyrtare e Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton që bashkëshortja e ankuesit, Sh. K., ka regjistruar aktivitetin e saj tregtar me numër Nipti: M.....I. Sipas Ekstraktit, fusha e veprimtarisë së aktivitetit të subjektit ankues është "Tregtim artikuj plazhi". Gjatë viteve 2022-2024, rezulton se subjekti ankues dhe bashkëshortja e tij, kanë arkëtuar pranë Bashkisë Shkodër detyrimet dhe taksat vendore të aktivitetit tregtar. Referuar provave të administruara, Sh. K. kishte vendosur në adresën sipërcituar, një objekt të quajtur "rulot", të pajisur me rrota, të lëvizshëm përmes tërheqjes nga një mjet motorik (automjet). Sipas ankuesit, ky objekt ishte i vendosur në atë vend prej rreth 12 (dymbëdhjetë) vitesh.

Mbështetur në shkresën Nr. 290/1 prot., datë 18.04.2024, të Drejtorisë Rajonale të Mbrojtjes së Territorit Shkodër, rezulton që kjo e fundit ka kryer një inspektim përgjatë plazhit të Velipojës dhe

ka mbajtur procesverbalet përkatëse, për 30 objekte të konstatuara të kundërligjshme. Ndër to, është konstatuar edhe objekti i vendosur nga subjekti ankues në adresën: Pulaj, Rruga Nr. 2, Ndërtesa Nr. 7, Velipojë.

Në vijim, me Urdhrin Nr. 377, datë 19.04.2024, “Për prishjen e objekteve të kundërligjshme përgjatë vijës bregdetare, Qarku Shkodër”, nga IKMT, është urdhëruar prishja e objekteve të kundërligjshme të ndërtuara përgjatë plazhit të Velipojës. Në përmbajtje të këtij urdhri, me vendimin Nr. 142, datë 18.04.2024, është vendosur prishja e objektit të ankuesit. Mbështetur në Procesverbalin e IKMT, mbajtur nga ana e Drejtorisë së Zbatimit të Vendimeve më datë 20.04.2024, evidentohet se është ekzekutuar vendimi Nr. 142, datë 18.04.2024, për prishjen e objektit të paidentifikuar të ankuesit. Kjo mbështetur edhe në fotot e përcjella nga ana e IKMT-së.

Bazuar në ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, ka për qëllim të sigurojë respektimin e normave, standardeve, kushteve zhvillimore dhe legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit e burimeve ujore në të gjithë vendin, si dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, bazuar në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, të decentralizimit dhe subsidiaritetit, në bazë të ndarjes administrative.

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i organeve për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme dhe i përgjegjësive të tyre.

Në nenin 3, të këtij Ligji, përcaktohet “Organizimi i inspektimit”, duke parashikuar se:
“Kontrolli i territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit kryhet nga:

- a) inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore përkatëse.
- b) Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit”.

Në nenin 9, të këtij Ligji, përcaktohen përgjegjësitet e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, duke parashikuar se:

“Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, nëpërmjet kryeinspektorit dhe inspektorëve, ushtron këto detyra dhe përgjegjësi:

a) ushtron përgjegjësitë e veta në nivel njësie vendore drejtpërdrejt dhe pa asnjë kufizim për ndërtimet/punimet që lidhen me çështje, zona ose objekte me rëndësi kombëtare dhe në territor:
Zonat dhe objektet me rëndësi kombëtare dhe në territor, në kuptim të këtij ligji, janë zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, monumentet e kulturës, qendrat historike, parqet dhe zonat arkeologjike, pyjet dhe zonat e mbrojtura natyrore, monumentet natyrore, përfshirë zonat me karakteristika unike gjeografike, zonat me rrezik natyror, rrjetet ekologjike, burimet minerare e natyrore dhe rrjetet, komplekset dhe parqet industriale, rrugët kombëtare, linjat hekurudhore dhe infrastruktura ndihmëse, instalimet e infrastrukturës kombëtare, sektori i energjisë dhe komunikimit elektronik, aeroportet, portet e rrugët detare, zhvillimet në zonat ushtarake, vija bregdetare, brigjet dhe burimet ujore, lagunat, lumenjtë, liqenet, digat e dambat, tokat bujqësore,

spitalet publike, objektet dhe terrenet sportive, si dhe ato të përcaktuara me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit e me akte nënligjore ose ligje të tjera;

b) kontrollon zbatimin e dispozitave të këtij ligji nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të njësisë në nivel të qeverisjes vendore;

c) kontrollon zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore dhe merr masat përkatëse, sipas dispozitave ligjore përkatëse në fuqi;

ç) kontrollon përmbushjen e kërkesave ligjore për materialet dhe produktet e ndërtimit që hidhen në treg dhe merr masat përkatëse sipas dispozitave ligjore përkatëse në fuqi;

d) kontrollon përmbushjen e kërkesave ligjore për shfrytëzimin e karriera të nxjerrjes së materialeve të ndërtimit dhe për pusët e ujit dhe merr masat përkatëse sipas dispozitave ligjore përkatëse në fuqi;

dh) ushtron përgjegjësitë e parashikuara shprehimisht në ligje të tjera.”

Neni 9/1, parashikon se: “ 1. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, përveç detyrave të tjera, të parashikuara në këtë ligj, ka të drejtë që:

a) të ushtrojë përgjegjësitë e veta të njësisë vendore, sipas nenit 5, të këtij ligji, për ndërtime/punime të kundërligjshme në territorin e njësisë vendore, që nuk përfshihen në çështje, zona ose objekte me rëndësi kombëtare dhe në territor;

b) të ushtrojë të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj lejes së ndërtimit, të miratuar në kundërshtim me ligjin dhe/ose dokumentet e planifikimit në fuqi.

2. Përgjegjësia, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, ushtrohet kur:

a) kërkohet nga vetë Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore ose nga kryetari përkatës i saj, për shkak të pamundësisë financiare për ushtrimin e kësaj përgjegjësie nga inspektorati vendor;

b) inspektorati vendor nuk e ka inspektuar këtë territor më parë ose nuk është shprehur me vendim për ligjshmërinë ose jo të ndërtimit/punimit, në përputhje me afatet dhe procedurat ligjore;

c) vendimi i inspektoratit vendor për prishje të ndërtimit të kundërligjshëm nuk është ekzekutuar brenda afatit ligjor të caktuar në këtë ligj.

3. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, gjatë ushtrimit të kësaj detyre, për të provuar kundërligjshmërinë e ndërtimit, kryen inspektim në ndërtimin/punimin, objekt inspektimi, sipas nenit 12, të këtij ligji, dhe në rast se në përfundim të inspektimit konstaton se ndërtimi është i kundërligjshëm, vepron sipas nenit 13 të këtij ligji.

4. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, për ushtrimin e përgjegjësisë sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, bashkërendon punën me autoritetet përgjegjëse përkatëse të planifikimit të territorit në nivel qendror”.

Neni 12, i Ligjit, parashikon se: “1. Për ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore kryejnë inspektime me një grup inspektimi, i cili ka në përbërje jo më pak se dy inspektorë, ose me një grup inspektimi të përbashkët, i cili ka në përbërje një inspektor të IKMT-së dhe një inspektor të njësisë vendore.

2. Kryeinspektorët/inspektorët kanë të drejtë të hyjnë dhe të ushtrojnë kontroll në mjediset ku kryhet ndërtimi.

3. Kryeinspektori/inspektori duhet të identifikohet me dokument zyrtar.

4. Subjekti që kontrollohet (sipas rastit, investitori, zhvilluesi, ndërtuesi, projektuesi, zbatuesi i punimeve, mbikëqyrësi, kolaudatori, prodhuesi i materialeve të ndërtimit etj.) dhe të gjithë personat e tjerë të përfshirë në procesin e punimit/ndërtimit janë të detyruar të lejojnë kryerjen e kontrollit, të vënë në dispozicion të grupit të kontrollit të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga aktet normative në fuqi, si dhe të ndihmojnë në shqyrtimin e tij.

5. Gjendja e konstatuar gjatë kontrollit pasqyrohet në procesverbalin përkatës të konstatimit dhe nënshkruhet si nga kryeinspektori/inspektori që kryen kontrollin, ashtu dhe nga subjekti i kontrolluar ose përfaqësuesi i tij, kur ky është i pranishëm dhe nuk kundërshton të nënshkruajë. Një kopje e procesverbalit i jepet subjektit të kontrolluar.

6. Kur subjekti i kontrolluar nuk pranon të nënshkruajë procesverbalin ose nuk është i pranishëm, ky fakt pasqyrohet në procesverbal dhe nënshkruhet nga grupi i inspektimit. Kur subjekti nuk është i pranishëm, i jepet një kopje e procesverbalit brenda 5 ditëve nga data e kontrollit.

7. Nëse identiteti dhe adresa e subjektit të kontrolluar nuk dihen, një kopje e procesverbalit të konstatimit afishohet për 5 ditë në vendpublikimet e njësisë vendore përkatëse dhe në kantierin e ndërtimit. Me kalimin e këtij afati, vlerësohet se subjekti i kontrolluar është njoftuar për rezultatin e kontrollit... ”.

Neni 13, “Dhënia e vendimeve administrative dhe afatet”, përcaktohet se: “Brenda 10 ditëve nga mbajtja e procesverbalit të konstatimit të kundërvajtjes, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, të cilat nënshkruhen nga kryeinspektori.

Vendimi për pezullimin e punimeve në ndërtim merret në rastin kur është i nevojshëm një afat kohor paraprak për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe të urbanistikës ose për marrjen e vendimit për prishjen e objektit.

Pezullimi i punimeve në ndërtim ka afat deri në 60 ditë.

Një vendim i tillë merret në rastet kur:

a) subjekti i kontrolluar mungon në objekt ose nuk i paraqet grupit të inspektimit dokumentacionin teknik e/ose ligjor të punimit/ndërtimit, që ka të bëjë, sipas rastit, me projektimin, mbikëqyrjen, zbatimin dhe/ose kolaudimin e punimeve të ndërtimit;

b) mungojnë masat e sigurimit teknik në objekt dhe mjetet mbrojtëse të jetës së punëtorëve;

c) plotësimi i dokumentacionit tekniko-ligjor kërkon proces miratimi nga autoriteti përgjegjës i planifikimit;

ç) vendimi i pezullimit të punimeve të ndërtimit për plotësimin e dokumentacionit teknik e/ose ligjor ka rezultuar i pamjaftueshëm dhe subjekti ndërtues kërkon zgjatjen e afatit, duke e argumentuar në mënyrë zyrtare.

Vendimi i pezullimit të punimeve në ndërtim shoqërohet me vendimin për dënim me gjobë, sipas parashikimeve ligjore, si dhe, kur është rasti, me kallëzimin penal apo kërkesën për heqje të licencës subjektit kundërvajtës.

Gjatë periudhës së pezullimit të punimeve në ndërtim, subjekti ndërtues është i detyruar të ndërpresë punimet në objekt dhe inspektorati vendor përkatës është përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi. Në rastet kur vendimi merret nga IKMT-ja, ky i dërgon, brenda 5 ditëve, vendimin e pezullimit inspektoratit vendor, i cili e zbaton atë brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga ana e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësive Vendore”, ka parashikuar në mënyrë të detajuar unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (më poshtë IKMT-ja) dhe ai i njësisë vendore, nga ku përgjegjësitë dhe mënyra e ushtrimit të kompetencave, specifikohen si më poshtë vijon:

“a) Kryeinspektorët/inspektorët e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore...

i) kanë të drejtë të hyjnë dhe të ushtrojnë kontroll në mjediset ku kryhet/en ndërtimi/et...;

b) Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë njësisë vendore:

i) zbaton vendimet e marra nga organi i qeverisjes vendore në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së territorit e disiplinimit të punimeve në ndërtim, brenda territorit nën juridiksionin e tij;

ii) kryen kontrole në territorin administrativ të njësisë vendore, në bazë të planit mujor të punës, të miratuar nga kryeinspektori, si dhe në bazë të njoftimeve të marra nga institucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizike e juridike...;

.....

4. Kryeinspektori/inspektori i inspektoratit të njësisë vendore, pas kontrollit në objekt apo në vendin ku kryhen punimet, mban procesverbalin, ku pasqyrohen gjendja aktuale, mangësitë dhe detyrat për subjektin ndërtues, dhe, për shkeljet e vëna re, zbaton procedurat ligjore në përputhje me nenin 12, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar.

Procesverbali përkatës i konstatimit nënshkruhet si nga kryeinspektori/inspektori që kryen kontrollin, ashtu dhe nga subjekti i kontrolluar ose përfaqësuesi i tij, kur ky është i pranishëm dhe nuk kundërshton të nënshkruajë. Një kopje e procesverbalit i jepet subjektit të kontrolluar.

Kur subjekti i kontrolluar nuk pranon të nënshkruajë procesverbalin ose nuk është i pranishëm, ky fakt pasqyrohet në procesverbal dhe nënshkruhet nga grupi i inspektimit. Kur subjekti nuk është i pranishëm, i jepet një kopje e procesverbalit brenda 5 (pesë) ditëve nga data e kontrollit.

Nëse identiteti dhe adresa e subjektit të kontrolluar nuk dihen, një kopje e procesverbalit të konstatimit afishohet për 5 (pesë) ditë në vendpublikimet e njësisë vendore përkatëse dhe në kantierin e ndërtimit. Me kalimin e këtij afati, vlerësohet se subjekti i kontrolluar është njoftuar për rezultatin e kontrollit.

Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e mbajtjes së procesverbalit të konstatimit të kundërvajtjes, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, të cilat nënshkruhen nga kryeinspektori.

.....

7. Vendimi për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm merret në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së territorit, si dhe në të gjitha rastet kur nuk respektohet vendimi i pezullimit të punimeve në ndërtim, nuk plotësohet dokumentacioni, teknik e ligjor dhe kur ka parregullsi në zbatimin e punimeve në objekt, brenda afatit kohor të parashikuar në vendimin përkatës. Vendimi për prishje shoqërohet me vendimet e dënimit me gjobë dhe për kundërvajtësin përgatitet kallëzimi penal, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Vendimi për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm mbahet sipas formës së parashikuar në aneksin shoqëruar të vendimit.

.....”.

Mbështetur në shkresën Nr. 4434/7 prot., datë 14.10.2024, drejtuar Komisionerit, IKMT thekson se përmes shkresës nr. 290/2 prot., datë 19.04.2024 “Kërkesë për shpallje”, ka njoftuar Bashkinë Shkodër për të bërë prezent shpalljen e njoftimit dhe vendimeve të mbajtura nga IKMT sa i përket procedurave të ndjekura për prishjen e objekteve të kundërligjshëm në plazhin e Velipojës.

Nga aktet e administruara, të mbajtura nga ana e IKMT-së gjatë procedurave të konstatimit dhe ekzekutimit të vendimeve për prishjen e objekteve të kundërligjshëm në plazhin e Velipojës, evidentohet se:

- Më datë 18.04.2024, Drejtoria Rajonale e IKMT Shkodër ka njoftuar IKMT-në lidhur me Procesverbalet e mbajtura gjatë konstatimit të objekteve të kundërligjshëm në plazhin e Velipojës;
- Po në datë 18.04.2024, nga ana e IKMT-së janë miratuar vendimet përkatëse për prishjen e secilit objekt të kundërligjshëm në plazhin e Velipojës;
- Më datë 19.04.2024, është miratuar Urdhri Nr. 377, datë 19.04.2024, “Për prishjen e objekteve të kundërligjshme përgjatë vijës bregdetare, Qarku Shkodër”;
- Më datë 20.04.2024, nga ana e IKMT-së është bërë ekzekutimi i vendimeve përkatëse për prishjen e secilit objekt të kundërligjshëm në plazhin e Velipojës, ndër të tjera edhe i subjektit ankues.

Sa më sipërcituar dhe mbështetur në parashikimet e pikave 6 dhe 7, të nenit 12 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, si dhe pikës 4, të VKM-së nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga ana e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësive Vendore”, IKMT nuk mori masa për:

- të vënë në dispozicion të Sh. K. brenda afateve të parashikuara një kopje të procesverbaleve të mbajtura;
- t’i lënë Sh. K. afatin e nevojshëm, 5 ditor të parashikuar nga aktet sipërcituar, për të marrë dijeni lidhur me njoftimin e publikuar në ambiente publike;
- t’i lënë Sh. K. afatin e nevojshëm, të parashikuar nga aktet sipërcituar, për të marrë dijeni lidhur me vendimmarrjen e IKMT-së sa i përket prishjes së objektit që ushtronte aktivitetin e tij tregtar;

- t'i lënë mundësi Sh. K. të zhvendos apo të marrë pajisjet dhe artikujt që ajo kishte lënë brenda objektit.

Edhe pse nga ana e IKMT-së është pretenduar se ka njoftuar Bashkinë Shkodër për të bërë prezent shpalljen e njoftimit dhe vendimet e saj, sa i përket procedurave të ndjekura për prishjen e objekteve të kundërligjshëm në plazhin e Velipojës, nuk u vu në dispozicion të Komisionerit asnjë provë lidhur me të. Nga Komisioneri nuk disponohet njoftimi i bërë Bashkisë Shkodër sa i përket pretendimeve të IKMT-së.

Pavarësisht faktit që se ka kërkuar nga ana e strukturave të Bashkinë Shkodër për të bërë prezent shpalljen e njoftimit dhe vendimet e saj, IKMT nuk rezulton se i ka dhënë afatin e mjaftueshëm të parashikuar nga legjislacioni sipërcituar, Sh. K. për të marrë masat dhe për të zhvendosur objektin ku ajo ushtronte aktivitetin tregtar.

IKMT në shkresën nr. 4434/7 prot., datë 14.10.2024, thekson ndër të tjera se: *“Pretendimet e ankuesit se “objekti është lehtësisht i identifikueshëm pasi Bashkia zotëron hartat sipas lejeve përkatëse që marrin shitësit ambulant të regjistruar me Nipt, si dhe objekti është i pajisur me matës të energjisë elektrike, i cili ka numër kontrate dhe emër e mbiemër”, nuk e vërtetojnë faktin se ndërtimi është kryer nga i njëjti subjekt që ushtron aktivitetin privat në këtë objekt, si dhe matësi i energjisë elektrike mund të jetë në emër të një subjekti tjetër”*. Sakaq, pavarësisht pretendimeve sipërcituar, IKMT nuk rezulton se ka kryer kërkime apo ka marrë informacion lidhur me pronësinë e objektit në fjalë, por ka vijuar me prishjen e tij.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se, arsyet e deklaruara nga IKMT për marrjen e masave për njoftimin e Sh. K. sa i përket procedurave të ndjekura për prishjen e objektit të tij, rezultuan të paprovuara. Në këto kushte provohet se Sh. K. është trajtuar në mënyrë të paligjshme, të padrejtë dhe të pafavorshme, sa i përket procedurës së ndjekur nga IKMT lidhur me prishjen e objektit të saj tregtar.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2⁸ të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstronohet se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që

⁸Neni 2: *“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”*

përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

Bazuar në dokumentacionin që disponon nga hetimi, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, A. K., mbart shkakun e pretenduar, atë të aftësisë së kufizuar.

“Aftësia e kufizuar” është shkak për të cilin ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Mbështetur në Librezën e lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Punës të Shqipërisë, Nr. 200, lëshuar më datë 31.12.2023, shtetasi A. K. rezulton person me shkallë invaliditeti të plotë. Në këtë kuptim, Komisioneri vlerëson se shtetasi A. K., bart shkakun e aftësisë së kufizuar.

Përsa është cituar më sipër edhe në këtë vendim, objekti i prishur nga ana e IKMT, nuk ka dokument pronësie, por aktiviteti privat i cili ushtrohet në këtë objekt, rezulton të jetë në emër të bashkëshortes së ankuesit, Sh. K.. Nga informacioni i dhënë nga ana e ankuesit, aktiviteti privat i ushtruar në objektin në fjalë, ishte një biznes përmes së cilit ata siguronin të ardhurat familjare, duke qenë se ai nuk ishte në gjendje të punonte për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në kuptim sa më sipër, referuar faktit që aktiviteti ishte ndërtuar për të siguruar të ardhurat familjare, si pjesë e saj, ankuesi ka pretenduar se i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e IKMT.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm të ankuesit, me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar faktin se Sh. K. është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e IKMT, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe trajtimit të paligjshëm, padrejtë apo të pafavorshëm të saj.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se, Sh. K. i është nënshtruar një qëndrimi të paligjshëm, padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e IKMT-së.

Neni 18, i Kushtetutës, i cili sanksionon parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, sanksionon: “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive”. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, duke theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. (Vendimi nr. 18, datë 29.07.2008, Vendimi nr. 19, datë 09.07.2009, Vendimi nr. 4, datë 12.02.2010, Vendim nr. 31 datë 04.10.2021)

Neni 59 “Objektivat social”, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: “1. Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon: e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët; ...f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës; ...”.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Neni 14 i Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, ndërsa Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka interpretuar se aftësia e kufizuar⁹ dhe moshë¹⁰, gëzojnë mbrojtje nga diskriminimi në kuadër të termit “çdo shkak tjetër”. Ndërkohë Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

*Karta Sociale Europiane*¹¹, e rishikuar në nenin 30 “E drejta e mbrojtjes nga varfëria dhe përjashtimi shoqëror”, pika a, parashikon: “Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës së mbrojtjes nga varfëria dhe përjashtimi shoqëror, Palët angazhohen: Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes nga varfëria dhe përjashtimi shoqëror, Palët angazhohen: a. të marrin masa brenda kuadrit të një përqasjeje të përgjithshme dhe të koordinuar për të nxitur aksesin efektiv të personave që jetojnë ose rrezikojnë të jetojnë në një situatë të përjashtimit shoqëror ose varfëri, si edhe të familjeve të tyre, veçanërisht në punësim, strehim, trajnim, arsimim, kulturë dhe asistencë sociale dhe mjekësore; ...”.

⁹ Shiko: *Glor kundër Zvicrës*, Aplikimi Nr. 13444/04, 30.04.2009; *Guberina kundër Kroacisë*, Aplikimi Nr. 23682/13, 22.03. 2016.

¹⁰ Shiko: *Schwizgebel kundër Switserland*, Aplikimi Nr. 25762/07, 10.06. 2010.

¹¹ Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

Garancitë për mbrojtjen nga diskriminimi parashikohen në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Evropiane, ku parashikohet: “Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Kartë do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkakut të tillë si race, ngjyre, seksi, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjinë shoqërore, shëndeti, shoqërimi me një minoritet kombëtar, lindjeje ose statusi tjetër.” Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale (KEDS), ka interpretuar se, aftësia e kufizuar përbën një shkak të mbrojtur nga diskriminimi, në kuadër të çdo “statusi tjetër”.¹²

Me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”¹³, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” (në vijim KDPAK). KDPAK përfaqëson standardin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektin e dinjitetin e tyre të lindur (neni 1). Konventa nuk jep një përkufizim të aftësisë së kufizuar, por pranon se aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave/pengesave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambientit që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët (Preambula e KDPAK, gërma “e”). Rrjedhimisht në qendër të vëmendjes nuk duhet të jetë paaftësia/paafhtësitë e mundshme, por kufijtë që ngre shoqëria, duke penguar gëzimin e të drejtave.

KDPAK, garanton të drejtën për jetesë të pavarur dhe përfshirje në komunitet të personave me aftësi të kufizuara në nenin 19, ku sanksionohet :

“Shtetet palë në këtë konventë pranojnë të drejtën e barabartë të të gjithë personave me aftësi të kufizuara për të jetuar në komunitet, me zgjedhje të barabarta me të tjerët, dhe duhet të marrin masat e duhura dhe efektive për të mundësuar që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht këtë të drejtë dhe përfshirjen e pjesëmarrjen e tyre të plotë në komunitet, përfshirë dhe sigurimin e faktit se:

- a) Personat me aftësi të kufizuara kanë mundësinë për të zgjedhur vendin e tyre të banimit, ku dhe me kë do të jetojnë në baza të barabarta me të tjerët dhe nuk janë të detyruar të jetojnë në një mënyrë të veçantë të caktuar jetese;*
- b) Personat me aftësi të kufizuara kanë mundësi për një gamë të gjerë shërbimesh mbështetëse në shtëpi, shërbime rezidenciale dhe shërbime në komunitetet, dhe për parandalimin e izolimit dhe veçimit nga komuniteti;*
- c) Shërbimet dhe mjetet komunitare për popullatën në përgjithësi janë të disponueshme në baza të barabarta për personat me aftësi të kufizuara dhe u përgjigjen nevojave të tyre.”*

¹² Shiko: *European Action of the Disabled (AEH) kundër Francës*, Ankesa Nr. 81/2012, 11 .09. 2013, prg. 132; *International Association Autism-Europe kundër Francës*, Ankesa Nr. 13/2002, 4 .11. 2003, prg. 51.

¹³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtësën KDPAK.

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.(në vijim ligji nr. 93/2014) Në nenin 3, pika 9, të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se: “9. “Persona me aftësi të kufizuara” janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.” Një nga parimet bazë të këtij ligji, sanksionuar nga neni 4, germa ‘a’, të këtij ligji është parimi i mosdiskriminimit, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë.

Në nenin 5 “Jetesa e pavarur”, e ligjit nr. 93/2014, sanksionohet : “ 1. Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare. 2. Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht: f) në komunikim dhe informacion; ...gj) në aktivitete biznesi e sipërmarrje.”

LMD, i cili është legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi garanton mbrojtje nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar ndërsa në nenin 20, të tij, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Konkretisht në nenin 20, pika 1 dhe pika 2, germa “c”, të LMD, parashikohet: “ 1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi. 2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;..... ”.

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përlligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e

kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përligjjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (*Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet¹⁴. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme¹⁵. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, diskriminimi i drejtpërdrejtë, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme” dhe “bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm”¹⁶

LMD, është një ligj i cili është miratuar mbështetur dhe në zbatim të nenit 18 të Kushtetutës. Në linjë me interpretimin e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së, sipas LMD, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”*.

Sipas nenit 3, pika 1, të LMD të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet: *““Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Bazuar në nenin 5, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi

¹⁴ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fabián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

¹⁵ Shih: *Çështja Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24.10. 2019.

¹⁶ Shih: *Biao kundër Danimarkës, Dhoma e Madhe, datë 14.05.2016, § 89, Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Dhoma e Madhe 2010, datë 16.03.2010, prg. 61.

ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin 33, pika 7/1 të LMD-së ku sanksionohet se : “7/1. Në rastet kur pala ankuuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.” Një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit parashikohet edhe nga Kodi i Procedurave Administrative, duke parashikuar në nenin 82, pika 2, si vijon : “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.”

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni e ka zhvendosur/shpërndarë barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, fillimisht duhet të krijohet një prezumim i diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminim.¹⁷

Parimi i zhvendosjes/shpërndarjes së barrës së provës, në çështjet e diskriminimit është i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - *praesumptio iuris tantum* dhe po kështu bazohet tek logjika e përdorur për vendosjen e lidhjes mes fakteve që tregojnë trajtim të mundshëm diskriminues dhe ekzistencës së këtij trajtimi në realitet. Barra e provës zhvendoset/shpërndahet dhe pala kundër të cilës është paraqitur ankesa, për të vërtetuar se nuk ka patur diskriminim, duhet të rrëzojë supozimin faktik se ka patur diskriminim. Në aspektin procedural, si fillim duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar,

¹⁷ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018_en.pdf, fq.232.

është shkaku i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër.

Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është pikërisht bazuar në standardin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Ankuesi A. K. është një person me aftësi të kufizuar, i cili ka paraqitur ankesën në emër të bashkëshortes së tij, Sh. K.. Objekti ndërtimor, ku Sh. K. ka ushtruar aktivitetin e saj tregtar, në shkelje të legjislationit, pa marrë asnjë lajmërim, është prishur nga ana e subjektit ndaj të cilit është paraqitur ankesa, Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Sa më sipër rezultoi e provuar se, me sjelljen dhe mosveprimin e tij, IKMT, e ka ekspozuar ankuesin ndaj një trajtimi të paligjshëm, të padrejtë dhe të disfavorshëm.

Referuar provave dhe legjislationit të vënë në dispozicion, në rastin konkret nga ana e IKMT-së, duhet të ishin marrë masa për identifikimin në terren të objektit të ndërtuar nga A. K. dhe bashkëshortja e tij; t'i jepej mundësia e marrjes së informacionit lidhur me procedurat e prishjes së objektit, si dhe t'i jepej mundësia të hiqnin nga objekti materialet që ndodheshin në të.

Pavarësisht se, mund të jetë kërkuar nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit dhe Bashkisë Shkodër mbështetja e tyre në procesin e prishjes së objektit të ankuesit, IKMT nuk ka marrë asnjë masë efektive dhe bindëse për verifikimin e rastit apo të objektit të ankuesit, por ka vijuar menjëherë duke e prishur atë në shkelje të plotë të të drejtës së A. K. për tu njohur me procedurat e ndjekura nga ky institucion.

Gjithashtu, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka mbajtur të njëjtën frymë në Vendimin nr. 165, datë 13.11.2019, ku ka konstatuar diskriminimin e shtetases E. D. për shkak të gjendjes shoqërore.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se, praktika e ndjekur nga ana e IKMT-së, e ka vënë ankuesin, në kushte të pafavorshme, në raport me persona të tjerë të cilët ndodhen në situatë të njëjtë përsa i përket ndërtimeve të jashtëligjshme dhe në kushte të ndryshme me të, për shkak të aftësisë së kufizuar të tij. Në vijim të arsytimit, përveç faktit që nga ana e IKMT-së nuk janë zbatuar parashikimet ligjore për prishjen e objektit të ankuesit, gjithashtu nuk është vënë në dispozicion asnjë provë apo fakt se ankuesi është vënë në dijeni lidhur me procedurat e ndjekura nga IKMT për prishjen e objektit ku ai ushtronte aktivitetin tregtar familjar.

Në këto kushte, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e paligjshëm, të padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesi dhe rrjedhimisht trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i tij, përbën

diskriminim sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar të A. K., nga ana e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësia e kufizuar)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)